

ekrem
ajruli

PALOPATRI OTËT
PALOPATRI OTËT

Arbëria
Design 

Botues:
ArbëriaDesign

Recensues:
Ejup Ajdini

Ballina:
Afrim Bulica

Shtypi:
Shtypshkronja
ArbëriaDesign

ekrem.ajruli@gmail.com

cel. 071 275 854

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека
“Св. Климент Охридски”, Скопје

AJRULI, Ekrem

Palopatriotët / Ekrem Ajruli. - Tetovë: Arbëria design,
2012. - 120 стр. ; 21 см

ISBN 978-608-236-000-3

COBISS.MK-ID 91104266

Parathënie

Ekrem Ajruli është figurë e njohur krijuese, veçmas në fushën e poezisë satirike. Vazhdimisht është pritur mirë nga lexuesi në hapësirat shqiptare të Maqedonisë dhe më gjerë. Poezia satirike e këtij autori zë vend të rëndësishëm në kulturën e hapësirave tona letrare, përmes së cilës plotësohet zbrazëtira e krijimtarisë letrare e këtij lloji. Me këtë i hapën rrugë të reja satirës në letërsinë tonë, edhe atë me një natyrë të hapur e të guximshme, duke e justifikuar me një humor sa të mençur dhe përqeshës, po aq edhe ironik. Ai din t'i ironizoj ata që thirren të mëdhenj, apo idhuj. Me delikatesë i zbulon anët e ulëta, të shëmtuara dhe ato qesharake.

Për këtë mund ta kujtojmë poezinë Nostalgjia:

*Thoshin zgjeboproletarët
Kemi një atdhe
Shtrihet nga Sibiri
Gjer poshtë në Egje.*

Kjo poezi nuk ka asnjë maskomani, dhe mu për këtë, në njëfarë forme autori paguan njëfarë haraçi dekadë pas dekadë. Këndi i tij krijues, përveçse është interesant, ai dallohet edhe për nga optimizmi dhe krenaria edhe pse ajo nuk aplikohet sa duhet.

E. Ajruli deri më tani botoi këto përmbledhje me poezi satirike: “Marshi i demonëve” (1995), “Rroftë e qoftë Lolestani” (2004), “Kur qesh doktor valuta” (2007). Dhe tani përmbledhjen “Palopatriotët” (2012).

Te të gjitha përmbledhjet poetike në thelb hasim, përveç theksit të fuqishëm satirik, në të njëjtën kohë ato mbajnë me vete edhe dhembjen e tragjikes jetësore që e përcjellin botën e kohës sonë, veçmas atë shqiptare.

Herë-herë kjo poezi lexuesit i sjell edhe gëzime, sepse kjo poezi e guximshme, sjell dhe satirizon të keqen e vërtetë. Ajo na bën të ndjejmë më thellësisht dhe të kultivojmë besimin për një të ardhme më të mirë, pasi bota nuk është bosh, ajo ka edhe poet që janë kujdestar dhe sulmojnë në vazhdimësi të keqen dhe të shëmtuarën në mesin tonë. Njëherit na bënë që të mësojmë nga gabimet dhe të këqijat që përvidhen në mesin e shoqërisë sonë.

Arti i këtij autori nuk është i zbrazur në asnjë moment, por gjithmonë është një terapi psikologjike për lexuesin, përkundrazi gjithmonë ka një qëllim dhe një porosi të caktuar, siç duket qartë te poezia Atme:

*atdhe i dashur
ç'të gjeti sot
shpirtin ty ta nxinë
emrin ta kanë ndot*

.....
*pjellat e përdala
që i lakmohen lekut
të sulen pa mëshirë
për hesap të grekut.*

Me energjinë e madhe për poezinë satirike, Ekrem Ajruli dëshmohej veçmas në përmbledhjen e kësaj radhe “Palopatriotët”, me të cilën u kundërvihet fenomeneve të ashpra shoqërore dhe vetive të ulëta të individëve.

Këto poezi janë të hapura dhe pa e fshehur vetveten, pasi duken qartë gjurmët dhe mendimet që ka përçarur nëpër këto vargje. Rrallë ndodh që ndonjëra nga këto satira të jetë e pakripur, sepse gjithmonë sjell një gjellë të shijshme poetike. Vazhdimisht mëton që këtë lloj poezie ta ngrejë në shkallën e një humori satirik të moderuar. Ai shkruan pa ekuivoqe, ashtu si i vjen dhe si e ndjen në shpirt. Nuk matën shumë e shumë se ku prek dhe kënd e hidhëron.

Autori ka guximin që të prek edhe strukturat më të larta pushtetmbajtëse si p.sh. te poezia Amaneti, të cilën ia kushton figurës së ndritur kombëtare-Ymer Prizrenit, ku edhe thotë:

Hej Ymer Prizreni

.....
*Në pyet për Pollogun
E kam lënë rrëmujë
Grinden bajraktarët
Për kolltuk të huaj*

.....
*Grinden bajraktarët
Hekur brejnë me dhëmbë
Mbi amanet dëshmorësh
Shkelin me dy këmbë.*

Në këtë drejtim nuk kursen as figurat politike evropiane. Me guxim i sulet Dik Martit, i cili me pa të drejt mundohet ta njollosoi dinjitetin e shqiptarit, veçmas atë pjesë që është më e shenjta dhe më sublimja për botën shqiptare:

*Vallë kujt i duhen sot
Organet tuaja-organe barbarësh*

.....
*Bota mirë e njeh
Gjakun tuaj të prishur.*

Përveç satirës, herë-herë të ashpër që të bën të mendosh thellë për shumë probleme të shoqërisë sonë në tërësi, kjo poezi sjell edhe një jehonë të lehtë humori, e cila e bënë këtë poezi më relaksuese dhe më të pranueshme për lexuesin. Rreth pentagrameve të qeshjeve dhe humorit dëshmon edhe poezia më, ku ndër të tjera thuhet: më

*Pate thënë ta heq këtë ves
Ndaj duhanin nuk e dua
Por cigaren s'e shmang dot
Ngase digjet veç për mua.*

Kjo poezi bëhet edhe më e kapshme pikërisht për atë se, pas çdo predhe satirike therëse e tallëse e të papritur, ndërhyjnë edhe me ndonjë fshikullimë humori, që në tërësi edhe humori edhe satira e ndihmojnë njëra tjetrën të sulmojnë të keqen dhe të ulëtën, si kategori estetike në mesin e shoqërisë sonë.

Përmbledhja “Palopatriotët” dallon dukshëm nga tri përmbledhjet e para, jo vetëm për nga forma dhe cilësia, por, ajo në veçanti dallohet pikërisht për nga motivet që trajtohen, pasi në këtë të fundit, autori shtyn edhe një cikël me motive të dashurisë, të cilat vijnë si krijime të papritura deri më tani. Edhe tek autori ndjehet një dilemë, por në fund të fundit ia arrin që t’i mund tabu-temat lokale për dashurinë dhe për këtë me vetëdije të plotë dëshmon te poezia ç’t’u:

ç’t’u

Bëj ndjenjave që nuk ndalen

As nuk ndrydhen

Si valë deti vijnë furishëm

Dhe në grykë të gjitha mblidhen

.....
Ca thonë se paskam lojtur

Në pleqëri paskam shkarë

Ku e dinë fatzinjtë

Se s’ka forcë që ndjenjat ndalë.

Siç duket, poetit ia ka marrë mend një vetullhollë, vetull e cila lahet me djersën e poetit dhe pastaj thahet nga dielli në ballin e saj.

Një motiv i tillë i jep mundësi autorit që edhe në këtë zhanër të krijoj vargje të realizuara bukur:

N’u bëfsha rreze dielli

Do të ulem përmbi vetull

Bulëz djerse le të bëhem

N’ballin tënd për t’u tretur.

Satiristi dhe humoristi, tani dhe poet i dashuruar, arriti që në njëfarë mënyre t'i përsosi në formë të ndjeshme krijimet e tij poetike. E kaliti me sukses këtë lloj poezie dhe me plot shprehje të pasura në mendime, me plot figura stilistike dhe mjaft aktuale për kohën dhe hapësirën kur jeton dhe vepron autori. Ndër të tjera, herë-herë haset ndonjë ngutje e ndonjë vargu, ku mund të kërkohet ndonjë gjetje më e përshtatshme, apo edhe ndonjë strofë që mund të ngritet në një nivel edhe më të lartë, duke ia rritur muzikalitetin, apo duke ia gdhendur vargun.

Marrë në tërësi, Poezia satirike e E. Ajrullit plotëson shumë standarde bashkëkohore. E veçanta është se, derisa në kohën e realizmit socialist humori dhe satira ishin të papëlqyeshme si kategori estetike, tani në kohën e demokracisë, kjo poezi vjen si nevojë dhe si plotësim i asaj zbrazëtire të gjatë kohore.

Ejup Ajdini

mriz
i horrave

iku

koha e luftëtarëve
në skenë dalin “komandantët”
n’pushtet ngjiten matrapazët
n’politikë prijnë diletantët

sot në kohë të pakohë
për vlera vend nuk ka
horri flet për moral
hajduti bëhet evlia.

amaneti

hej Ymer Prizreni
ç'është ky amanet
në këto ditë qershori
në Prizren pse më thërret

në pyet për pollogun
e kam lënë rrëmujë
grinden bajraktarët
për kolltuk të huj

grinden bajraktarët
hekur brejnë me dhëmbë
mbi amanet dëshmorësh
shkelin me dy këmbë

më thuaj Ymer Prizreni
pash perëndinë
me burra të tillë
do t'bashkojmë Shqipërinë

ka djem shqiptaria
që s'përkulen kurrë
mblidhen për atdhe
digjen për flamur

ja tek vinë tribunët
radhitur në radhë
ja T.Sinani, ja R. Beqiri,
ja M. Aliu
u prin Haxhi Ymeri
mbi gjokun e bardhë

përditë

në pakon e cigareve
lexoj
duhani vret
sulmon në tru

çudi
çdo ditë përballem
me qindra joduhanxhinj
truvrarë

ferrì

gjersa ti pas hyjnive
rend poshtë në Purgator
unë përleshem këtu
me cerber e kremator

kot zbritë në ferr
ti Dante Aligeri
këtu në cep t'Evropës

sundon Luciferi

atme

atdhe i dashur
ç'të gjeti sot
fytyrën ty ta nxinë
emrin ta kanë ndot

ca turma hordhish
të sulen përmbi
të t'shndërrojnë në gërmadha
nga jugu në veri

burokrat të fëlliqur
të rritur në llum
këlysh stramastiku
të të njëjtit brumë

të sulen tani
nëpunës llumpenproletarë
vërsulen hienat
dhe nuk kanë të ndalë

pjellat e përdala
që i lakmohen lekut
të sulen pa mëshirë...
për hesap të grekut

krrokamë

krrokamë sorrash në vjeshtë
krrokamë horrash në verë
zhurmë vertebrorësh që nuk hesht

krrokamë sorrash në mot me shi
krrokamë horrash në mot me diell
zhurmë bezdisëse që t'ngjallë
neveri

përzierje krokamëglasash
kah do poshtë-lartë
mozaik fekalesh kudo mbi asfalt

mbi degë të blirit pushojnë sorrat
krrokama ngjall trishtim
nën hije degësh mrizojnë horrat
vallë ku e ka vendin soji im.

ah

moj gojë e bekuar
ndale hovin boll gllabërove
nga makutëria e tepruar
pak si tepër më ngarkove

mos më shaj lum prapanica
faj ka barku që të ri përmbi
urdhëron ai e sjellin duart
unë kam urdhër veç të gri.

dhjetëra emra më kanë vënë
s'i mbaj mend dot të gjithë
për një jam e sigurt
e di se e kam emrin bythë

le të m'quajnë si të duan
vithe, zuzë prapanicë
për lakmi të karrieristëve
unë bëhem sakrificë

Lypësi

duart shtrirë kah shpresa
sytë përplot melankoli
e rrahin erërat shiu pamëshirë
kurrë nuk gjen ngrohtësi

trastën plotë premtime
si e kalon natën ku
skutat parqet ka atdhe
shtëpi kartonët **MADE IN EU**

erdhi

maji me behar
bleruan fusha-bleruan male
sulet grigja politike
në fushatë blegtorale

rendin e nuk ndalen
thonë bëjmë historinë
qeshu millet qeshu
hajdutët të sjellin “**LIRINË**”

Ë sÿrenës

rob le të jem
thellë në fund të detit
të frymojë mes valëve gurëve
sa këtu mes llumrrëmetit
t'u buzëqesh **Minotaurëve**

një

pëllumb
në fluturim
lëshoi glasën
mbi supin tim
thanë me fat-mbarësi
me fat apo pafat
mbi të gjitha s'ishte
Njeri

kasta

kasta juaj është pafytyrë
nga fjalët kurrë nuk skuqet
vidhni sa të mundeni
për një sharje
mos ndërroni huqet

erë arbërie

unë nuk njoh lider
as ngjyra partie
tokës time të shenjtë
dua t'i vijë erë arbërie

nuk më hyjnë në punë
biznes e kontingjente
atdheu im i shtrenjtë
vlen sa pesë kontinente

s'më ngazëllojnë aspak
kostum e kollare
zemrën ma bën mal
bardhësi e qeleshes shqiptare.

revoltë

Ti me pushkë -ushtar
Unë ushtar -me penë
Të dy -u dogjëm qiri
Me dekada -për **Atdhenë**

Ti shkrepje-armë
Unë derdhja-ngjyrë
Jetës t'i jepnim-kuptim
Patëm të vetmen-dëshirë

Me vite kërkam-lirinë
Andaj u dogjëm-pishtar
Sot trastën-kemi në shpinë
Ushtar e poet-në “paqe” Lypsar

nostalgjia

më kujtohen sot
ditët e rinisë
jeta jonë e "lumtur"
në prehrin e partisë
kur kaplonte acari
e frynte stuhia
kujdesej tirani
na nxehte partia

thoshin zgjeboproletarët
kemi një atdhe
shtrihet nga sibiri
gjer poshtë në egje

murtaja e kuqe
lindte xhelat
në çdo pore t'jetës
bënte roje
një njerilugat

thonë

bota është e madhe
male, fusha, oqeanë
horizont i pa skaj
s'qenka gjë
kjo botë muti
gjersa rasti
qenka mbret i saj

këto

tenjat e pushtetit
na e bënë jetën skëterrë
soji tyre dhjakonar
si mushkonja anofel

teleshmanët në ballë t'miletit
rrahin gjoks n'diplomaci
thërpehen me pushtetin
shpirti tyre është fillzi

themeldalë trumbetues
i ke kudo natë e ditë
fatin ton se farkojnë
dykëmbëshit troglodit

kokëdemi
variant

këpucë telatini vesh këmbëdemi
shkel zëshëm mbi mermer
zotëri hijerëndë
gojëmi e barkderr

s'janë të thjeshta si do këpucë
të përmbytura në djersë e baltë
janë këpucë burokrati
këpucë mëzat-njeriu shpirtguacë

miqtë

kudo thikarët mbjellin trishtim
çdo ditë përplasemi me llumin
kërkoj mik të shpreh shqetësimin
miq i kam poetin dhe llumin

sodis ecjen e tyre stoike
çdo valë çdo varg me mua flet
bota është plotë llovrak e llum
ndaj bjeru mik poet

ky rreth është përplot handrak
ndaj merri gjërat shtruar, pa ngut
fjala jote është zjarr që frugullon
mik ti nuk je dhëmbësutë

poetët

poetët s'janë eng,
siç duan ca themeldalë.
janë koka që s'durojnë cengë,
si ju lumpenproletarë.

thërpehuni kur të doni,
me sojin tuaj fillzi.
vargut s'ia ndal flurudhën,
e trogloditëve usi

dy

dy dekada ti shushunjë
thithe gjak e djersë
kur ta patëm nevojën
na vure kufi telagardh

ne ëndërrojmë
edhe sot për ty
Evropë tualet i madh

ë

pagjumi m'pyet
mik si je
si paraardhësi i njeriut
sipas shkencës-i them

miku shikon
përvuajtshëm
majmunët shkulen
së qeshuri

palopatriotët

iku dimri
erdhi behari
fushën politike
shpejt e mbuloi bari

janë vënë në garë
“nacionalist” - “demokrat”
vrapirojnë nëpër mjegull
të hajnjериut argat

alarm

globi kollitet
dridhet ka ethe zjarrmi
sylugatët alarmojnë
kujdes është pandemi

nga erdhi vallë
kush e di
vërtet fajtorë janë shtazët
apo e polli si çdoherë
përbindëshi-**NJERI**

kudo
në seanca-kongrese debate
vampirë në frak të zi
lëvizin institute klinika-qeveri
gripi (H1N1)
shpikje e derrave
SURRATNJERI

kam atdhe

më quani si të doni
ateist me e pafe
s'më bëhet vonë aspak
unë kam **ATDHE**

nderoj njerëzisht
kryq hënë e yll
mbi të gjithë
e dua **SHQIPTARINË**
ajo më ngroh si
DIELL

Ju pseudokambana-minare
që shurdhoni-shponi
tokën-qiellin
Ikni ikni në Tartar
Mos e zini diellin

Aullimat që vijnë
nga Moska-Bagdadi
Athina apo Vatikani
janë zëra mafiozësh
janë shurrë shejtani

shokut

E. Ajdinit

me ty një kali kripë
nuk kam ngrënë
e di
por kafe mik
mbi një tonelatë
bashkë kemi pi

u lodhët

ju pusht(et)arë
numëroni dengje parash
kontingjentet-godinat
populli lehtë e ka
numëron
VIKTIMAT

lagaterë

në këtë kohë lagaterë
guximi është marrëzi
rrungajë gropsharësh
që t'ngjallin neveri

(ar)mikut

Dik Martit dhe miqve të tij

Në shekuj mbetët egërsira
T'mbrujtur me vese lakmitarësh
Vallë kujt u duhen sot
organet tuaja-organe barbarësh

Për krime ndaj fqinjëve
keni pri me etër e gjyshër
bota mirë e njeh
gjakun tuaj të prishur

kot kërkoni rrënjët
në lumenjtë dhe të miat male
Sibiri është atdheu juaj
Kjo është tokë shqiptare

hordhi

ju hordhi karpatesh
edhe më tej mund të shtini
shishe martinoviqësh
thellë në anusin tuaj
për të “bindur” botën
se Atdheu im është tokë e juaj

nasradini i
braktisur
(noliane)

po ta shihni në bit-pazar
me gotë vere në dorë
mos bëhi kureshtar
është nasradini bashkëkohor

i vetmuar i hutuar
“disidenti”-shkrimtar
n’mes lëndinës rri shushatur
hipur prapthi mbi gomar
rri e pret të mbijë bar në janar

seç ndërsehet-e hakërrehet
sa herë ia do nevoja
me pushtetarë shpesh thërpehet
sjelljes tij i doli boja

agallarët-hoxhallarët
doktorët-namqorët
burokratët-sylugatët
i japin krah e ymyt
jeta e tij-jetë margjënori
seç po sosit për çdo ditë

dikur kishte një shoqatë
u shpall princ pakufi
e shndërroi në principatë
nasradini i shekullit t'ri

hëngri fshiu tërë një lidhje
se penguan bëri ç'deshi
po kur gënjeshtër mori dhenë
n'dorë i ngeli vetëm preshi

seç ushton e na shurdhon
rreth mulla(rit)-bit-pazarit
anës vardarit shpateve t'sharrit
hungërima e çakallit

në

çairin e bleruar
mrizon lopa me një viç
qetë kullotin do gomar
një kërraç dhe dy kërraç

pyesin kërraçat me djallëzi
kënd ke babë a e di
kërraç ngrata veshët përpjetë
e galduar shikoi malin
krenarisht me zë të lart
tha: **unë dajë e kam kalin**

o njeri

robtohu për veten
në do të jetosh me nderë
mos u bën
argull në lëkurë të huaj
as leckë e pavlerë

robtohu për sedrën tënde
ndryshe lumi të mori
fytyra është një pëllëmbë
s'është gomë traktori

(si)mik

askush s'të ka lakmi
për bazhgaret në letër
badër bëhesh kudo
ti kërroçe e vjetër

grin e shanë dy dekada
njërit këlysh tjetrit gomar
mendja jote e zezë si nata
veten vallë e ke parë

kush s'të ka lakmi
ty abe nate
troglodit që nxjerr usi
dhe adra bajate

dikush qenka korb për ty
tjetri sorrë apo buf
pusho pak o mendjebukur
pse digjesh si stufë

nëse të thanë të pushosh
s'besoj se bënë mëkat
le të të vijë erë njeri
mos u kalb në ligatë

njërit hut tjetrit sorrak
gojën përplot ndyrësirë
gryka jote vjell handrak
shihu në pasqyrë

kush

kush të prish ëndrrën
shpirtin ta bën farmak
vetja të duket ujk
ty lepecit plak

flet e shan përçartë
donë të bësh nam
seç të tradhton mendja
nis e vjell ballgam

mos kërcëlo dhëmbët
se t'thyet dhëmballi
fjalët janë varfëri
angullinë çakalli

epigram

nis të shkruaj elegji
ngase borxh ta kam
ç'më tradhton varg i bekuar
për inat del epigram

lavdet tua nuk kanë fund
as nuk kanë të sosur
të ndihmoftë Perëndia
truri t'është dhjamosur

tundet

tundet shkundet tërë çarshia
dridhet bit-pazari
kundërmon gjysmëqyteti
me parfum gomari

në degë të rrapit agjëronja
grin e bën shamatë
bubuzheli i hakërryer
del nga bajgë e thatë

brontozauri nën hije t'rrapit
ka rënë në ekstazë
mizat CC rreth e qark
i këndojnë me emfazë

sytë gapërruar në lemeri
ngre e lëshon panxhën
angërdufi me butafori
donë të mbrojë ballanxhën

nis hakërryet ulërinë
bota i paska faj
bullubreshkës futëzezë
nuk i ndalet vaj - qan fatin e saj

nis e qanë kohën e ndritur
furuvejka në degë qarri
tërë bizgën që ka nxjerrë
donë ta ketë bashllëk tek varri

në jetë

kam parë bisha
kam parë ujq dhe arinj
kallpazan në këto vite
kam takua vetëm një

andaj jetës nuk i druhem
pa drojë i ngjitem malit
s'më spraps hungërimë e
bishave
aq më pak aullimë e çakallit

më rastis të dëgjoj shpesh
edhe këngën e hutit
por kurrë bletën s'e kam parë
të shkoj pas erës së m...

mëkat

të ofendoj qenin
me veset e lanokut lerash
buzik i trotuareve
u rrit dhe plaket lamash

kurrë s'do t'i fyej me të
gjallesat që i fali Zoti
bafres së baçkallomës
i vjen era qëmoti

ganeci

kush e ka shqetësuar
këtë bokërr oborri
pas beshteve me bisht
ja kokën e nxori

jep e merr me veten
i zhytur në llum
lanokët i bëjnë temena
kapucarit idhnak

ganeci xhindoset gërvallet
përjarget dhe s'i del inati
bota i paska faj
këtij birlugati

imamhajtut

lanokët angërdufët me bujë
shkruajnë-ankohen për pabesi
akuza stramastikësh-**HIPOKRIZI**

tenjat anjëzat
pëshpëritin për moral e parim
lamashët turfullojnë
ladutëri kusarësh-**TRISHTIM**

kapucarët kallpazanët
thonë bobëzat ecim vertikalisht
çirren për nderë e besnikëri
beso bukëharamët-argujt me bisht

lapërdharët lëngarak
flasin për burrëri
imamhajdutët të mësojnë
edukatë
fali **O PERËNDI**

hajnjeriu

shih se kush na fyen
pa shih kush na shan
soji i vampirëve
na quan satan

goja i vjell vrer
sytë i kullojnë gjak
nipi i vurrkollakut
han e vjell handrak

nomadi shfryn e shan
me epshe shtazarake
gjenezën ia gjen larg
te mbeturinat romake

s'ia kemi nevojën
sojit hajnjeri
le të shporret tej rodopeve
të ik në azi

s'na duhen kapucarët
e as levantinët
le të ikin tek të parët
të shkojnë tek pinguinët

kopilkapedani

quaj si të duash kundërshtarët
aspak mos u tutë
t'gjithë janë më t'mirë
se ti imamhajdut

me zë stramastiku
dhe penë poeti
shan baloshbuziku
pjellë imamlaneti

natën shan nëpunës
politikanë parti
fukadrugë bezdisëse
ngryset n'ministri

dhe mburrjet s'kanë fund
me hir e pahir
për vozën e verës
të pirë qelepir

ke thënë fjalë të mëdha
kudo ke lënë nam
zbulim epokal
morri paska dhjam

këtu

frymojë nuk rroj-ndaj dua të iki
nga ky rreth kerubinësh
ku më ngufatë
llumi-**DYFYTYRËSIA**
vdekjes jo s'i druaj
pas saj është **LIRIA**

Juve

pinjollë të **MIDËS**
çdo gjë u duket para-pasuri
ndaj përkuluni para **DIONISIT**
ai edhe handrakun u bën flori

në dasmën tuaj politike
ftoni **KENTAURËT**
miqtë tuaj t'vjetrit
kur dehja të arrijë kulmin
i hani kokën njëri-tjetrit

rrëmetit mos ia varni
nga raja mos keni droje
në **PURGATORIN** tuaj politik
KERBERËT u bëjnë roje

gushtovjeshitë

po të jem

pikë loti
brenda syve s'do qëndroj
do të shkas faqeve tua
afshin tënd të shijoj

do të qasem nën qerpik
dorës tënde s'i kam drojë
në cep të buzëve të ndalem
ato buzë t'i shijojë

do të bëhem gotë kristali
që të mbledh të tuat lot
të shuaj zjarrin që më djeg
sa të jem në këtë botë

do të bëhem pikë gjaku
zembrës tënde vrull t'i jap
diellhije le të bëhem
të të mbrojë n'acar e vapë

të bëhem burim jete
e të rrjedh brenda teje
të përshkoj shtatin tënd
dhe të ndalem thellë në deje

këto vargje nuk janë fjalë
fjalë goje që i merr era apo deti
janë fjalëzjarr të përmallshme
janë vargje të një p....i

jam

shkëmb buzëdetit
nuk jam zemërguri
pres sirenën në fllad mëngjesi
më magjeps i saj nuri

loti saj melhem plage
brenda meje po këndon
këngë e lotit është e ëmbël
shpirt e zemër i rinon

thërira

erën në natëverë
i dhashë amanet
për qafimin tim të zjarrtë
për sirenën që ri e pret

merr lotin e ëmbël të saj
ma sjell këtu në buzë lumë
fytyrën gushën pak ti laj
syrin tim të pagjumë

mali

rri e digjet në vetvete
posi prushi nën shpuzë
pret në heshtje i përzjarrtë
të vijnë t'i fryjnë ato b...

le

t'përplasen retë rrufetë
të përflaket tërë qielli
zëri yt vargu yt
seç më sjellë ngrohtësi dielli

ulur

rri në buzëlum
hedh shikimin larg në majë
monopatet seç më duken
posi floku i zi i saj

vjen lumi qetë qetë
herë me valë herë dallgëshumë
valë e tij këngë sirene
syrin tim e lë pagjumë

e ndjej...

mallin tënd si vjen
rreze dielli djeg në ballë
shpirti im zog qielli
ka nevojë për t'u çmallë

at shikim gurgacë
syri yt din ta derdh
zemra ime shpuzë deti
din mirë si ta mbledh

këto visare kaq të shtrenjta
i fsheh thellë n'fund të detit
i përkëdhel i ledhaton
oqean zemra e poetit

shpirti

pleqëria nis afrohet
porsi vjeshta në degë fiku
s'plaket shpirti i poetit
rrudhet ca vetëm fiziku

zemra e tij gurgacë
kërkon pranë një copë eshke
me të rënën e masatit
i vë flakën tërë një bjeshke

prita

muzën në ndajnatë
të më sjellë inspirimin
në këtë natë pak me shi
sa të shuaj përmallimin

sodis erën në fladmbremje
tek lazdohet mbi grunajë
më kaplon një dëshirëzjarr
të shpupuris vargun e sajë

rreze

dielli në degë fiku
shkëlqen bukur një pikë vesë
mendja iku s'di se ku
ndjenjë e vjetër flakë u ndez

në mollëz gishti seç e mora
atë pikë vese pak të zjarrtë
shijen shpejt ia ndjeva
ishte loti saj i nartë

me të lava ballin sytë
me të lag buzët pak
ngase goja e gurmazi
janë tharë e bërë farmak

taket

taket tua elegante
shkelin zëshëm mbi asfalt
hapi yt hap gazele
drithërimë më shti në shtat

s'janë të thjeshta si çdo take
të përmytura në baltë e djersë
janë take të përkryera
zgjojnë kureshtjen në mëngjes

çtu

bëj ndjenjave
që nuk ndalen as nuk ndrydhen
si valë deti vijnë furishëm
dhe në gryk të gjitha mblidhen

ca thonë se paskam lojtur
në pleqëri paska shkarrë
ku e dinë fatzinjtë
se s'ka forcë që ndjenjat ndalë

mali

buron nga zemra
merr flurudhën në pakthim
mali është lavë vullkani
shpërthen vrullshëm
me gjekëtimë

n' u

bëfsha skifter
apo të bëhem fajkua
nëpër natë me shtrëngatë
do të gjej vargjet tua

n' u bëfsha rreze dielli
do të ulem përmbi vetull
bulëz djerse le të bëhem
në ballin tënd për t' u tretur

sec

e ndej mallin tënd
eh ç' ndej tëndin mall
grimcë pluhuri vjen me erën
dhe më ngjitet në qepallë

më

pate thënë ta heq këtë ves
ndaj duhanin nuk e dua
po cigaren s'e shmang dot
ngase digjet veç për mua

madrigal

sa mund ndjenjat i ndrydh
nuk kam forcë hovin t'ua ndal
nis të shkruaj epigram
në fund më del madrigal

rrah mendimin hedh vargun
punë o punë drej o punë
hamullon ndjenjë e vjetër
madrigal del si përdhunë

deti yt

vargu yt mister deti
lavë vullkani mban n'thellësi
dhe në stinë të acarta
shkrin akuj sjell ngrohtësi

në natëmaj dëgjoj një këngë
thurë ca vargje pa kursim
aureolë ia vë hënës
përmbi re i nis n'udhëtim

marr një perlë nga deti yt
i vë krahët e kumrisë
dhe e nis drejt një caku
për hir të miqësisë

për këtë mall për këto fjalë
n'daç urrej n'daç më shaj
vargjet tua ndezin zjarr
siç e sheh unë skam faj

...dhe

ky deti i trazuar
vjen me burë e ushtimë
unë liburne e molisur
pres shtrëngatë sfida gjekëtimë

nuk më mposhtin lubidallgët
në vargperlë më ngec spiranca
ngjallet ndjenja djaloshare
duroj goditjet nga distanca

ndjek vargjet dritëylli
dhe frymëzimin t'mos ik
ndalet pena në një çast
nis të shkruaj një qerpik

melhemfjalë

lavë vullkani ndej n'thellësi
herë janë prush e herë thëllime
seç m'përcëllon diçka në gji
ah janë fjalë të MIKES sime

shpesh i nisi disa vargje
herë me hir e herë pahir
MIKJA vargjet i thadron
dhe m'i kthen xhevahir

ndaj s'e di kush më tundon
është shtojzovalle apo muzë
mbi të gjitha janë melhemfjalë
fjalët të ëmbla nga sajat buzë

n'të dyzetat

Ti n'të dyzetat
vapë përcëlluese
Unë n'të pesëdhjetat
ciknë acari

eja
kësaj dite
gushtovjeshtë
T'i japim shije behari

këto vargje

do t'i nis këto vargje-këto fjalë
në daç mallkomë e n'daç më shaj
vargjet tua trazojnë mall
andaj unë nuk kam faj

n'daç më shaj n'daç më urrej
për këto vargje plotë shqetësim
vargu yt më galdon
Ti po deshe lësho mallkim

vjen

vjen pranvera-shtatin hedhur
dhe lazdranja-duke u dredhur
gjeth e këngë-mbushet mali
trupi lazës-gotë kristali

gjoksin lart-beden kështjelle
s'din ç'është-skamja as kriza
syri plakut-shigjetë erosi
ngul shikimin-te kërthiza

shtati i saj-sikur bjeshkë
aromë dehëse-e borzilokut
nga copë akulli-bëhet eshkë
zemër e ngratë-e bablokut

hedh shikimin-anë e mbanë
dhe psherëtinë-thellë në vete
shpirt i fjetur-bëhet tufan
ah! rini-ku u trete

Përmbajtja

• Parathënie	3	• palopatriotët	44
<i>mrizë e horrave</i>		• alarm	45
• iku	11	• kam atdhe	47
• amaneti	12	• shokut	49
• përditë	15	• u lodhët	50
• ferri	16	• lagaterë	51
• atme	17	• (ar)mikut	52
• krrokamë	20	• hordhi	54
• ah	22	• nasradini i brraktisur	55
• lypësi	24	• në	59
• erdhi	25	• o njeri	60
• i sirenës	26	• (si)mik	61
• një	27	• kush	64
• kasta	28	• epigram	66
• erë arbërie	29	• tundet	67
• revoltë	31	• në jetë	70
• nostalgjia	33	• mëkat	72
• thonë	35	• ganeci	73
• këto	36	• imamhajdut	75
• kokëdemi	38	• hajnjeriu	77
• miqtë	39	• kopilkapedani	80
• poetët	41	• këtu	83
• dy	42	• juve	84
• i	43		

gushtovjeshtë

• po të jem	89
• jam	92
• thirra	93
• malli	94
• le	95
• ulur	96
• e ndjej...	97
• shpirti	99
• prita	100
• rreze	101
• taket	103
• ç'tu	104
• malli	105
• n'u	106
• seç	107
• më	108
• madrigal	109
• deti yt	110
•...dhe	112
• melhemfjalë	114
• n'të dyzetat	116
• këto vargje	117
• vjen	118

Ky libër u financua nga Ministria e Kulturës
e Republikës së Maqedonisë

Tirazhi: 1000 ekzemplar